



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



A.nr.351/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bektashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.351/2026, të datës 26.03.2026, të parashtruar nga ankuesi F.A, nga Gjakova, kundër organit të punësimit: Komunës së Gjakovës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.08.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.351/2026, e datës 26.03.2026, e parashtruar nga ankuesi F.A.

II. Mbetet në fuqi Akt Njoftimi i datës 13.03.2026, i Menaxherit të Burimeve Njerëzore, të Komunës së Gjakovës lidhur me shpalljen e kandidatit fitues në procedurën e pranimit me numër të referencës: RN00019195, si dhe Njoftimi i datës 20.02.2026, për refuzimin e aplikacionit të ankuesit.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, F.A (në *tekstin e mëtejme referuar*: Ankuesi), më datë 23.03.2026, përmes postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar në Këshill më datë 26.03.2026 dhe është regjistruar nën shenjën A.nr.351/2026, kundër njoftimit të datës 20.02.2026 për refuzimin e aplikacionit lidhur me konkursin me Nr. Ref: RN00019195, pozita Asistent Administrativ të shpallur nga Komuna e Gjakovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në *tekstin e mëtejme referuar*: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Gjakovës, ndërsa, kjo e fundit, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në *tekstin e mëtejme referuar*: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 1527/2026 të parashtruar nga ankuesi më datë 26.03.2026 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me Nr. Reference:

RN00019195 për pozitën Asistent Administrativ; Njoftimin për refuzimin e aplikacionit i datës 20.02.2026; Diplomën me Nr. 300 të ankuesit; Diplomën 07.07.2014 të ankuesit për kryerjen e shkollës së mesme; Kopjen e ID-së së ankuesit; Zarin e datës 23.03.2026; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 02.04.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 08.04.2026; Formularin për përshkrimin e detyrave të punës Asistent Administrativ; Vendimin e datës 08.01.2026 për themelimin e komisionit të pranimi; Aplikacionin e datës 03.02.2026 të kandidatës V.E me dokumentacionin nga faqe 1-7; Aplikacionin e datës 06.02.2026 të ankuesit me dokumentacionin nga faqe 1-4; Listën e aplikantëve; Njoftimin e datës 20.02.2026 për verifikimin paraprak; Njoftimin e datës 13.03.2026 për rezultatet përfundimtare.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e pabazuar, **sepse:**

I. Gjendja e çështjes

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton:

- Komuna e Gjakovës, më datë 08.01.2026, ka shpallur konkursin me Nr. Ref: RN00019195, Grupi i Administrimit të Përgjithshëm, pozita “Asistent Administrativ”, klasa profesional 3, një vend, më afat aplikimi 09.01.2026 deri 07.02.2026.

- Në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsej gjashtëdhjetë e pesë (65) kandidatë, ndërsa, sipas njoftimit të datës 20.02.2026, fazën e verifikimit paraprak e kanë kaluar katër dhjetë e dy (42) kandidatë, kurse, sipas Njoftimit të datës 20.02.2026, të Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës, ankuesi i është refuzuar aplikacionit me arsyetimin se në aplikacion nuk ka bashkangjitur diplomën e shkollës së mesme.

- Pas përfundimit të procedurës, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës, më datë 13.03.2026, ka publikuar njoftimin për rezultatet përfundimtare të vlerësimit me kandidatin fitues Vlora Efendija me 80 pikë.

II. Pretendimet ankimore:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton njoftimin e datës 20.02.2026 për refuzimin e aplikacionit lidhur me konkursin me Nr. Ref: RN00019195, me pretendimin se nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike sepse me vetë faktin që posedon diplomën e fakultetit është e kuptueshme se posedon edhe diplomën e shkollës së mesme, por meqë aplikimi ka qenë online nuk e ka kuptuar si nuk ka figuruar edhe diploma e shkollës së mesme. Pretendon se i është mohuar e drejta për konkurrim sepse plotëson të gjitha kriteret e konkursit. Kërkon që të ndryshohet njoftimi i atakuar dhe të mundësohet nënshtrimi në testin me shkrim.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit, me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, ju referuar Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publikë, gjegjësisht:

-Nenit 9 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7, ku përcaktohet: *1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë:*

1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës...

-Nenit 39 paragrafi 1, 7 dhe 8, ku përcaktohet: 1. *Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj. 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimi i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi.*

Kolegji i Këshillit, po ashtu ju referua Rregulloren (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, respektivisht:

-Nenit 7 paragrafi 1, ku përcaktohet: 1. *Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim në shërbimin civil plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit.*

-Nenit 11 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet: 1. *Vlerësimi përfundimtar i kandidatit përfshin shumën e pikëve të përfituara në secilin hap të vlerësimit. 2. Pas përfundimit të intervistës, Komisioni i Pranimi përgatit listën përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar pragun prej 70% të pikëve totale që e përcjell te NjMBNj, emrin dhe mbiemrin e kandidatit fitues, si dhe pikët e arritura në testin me shkrim, intervistën dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat.*

Referuar kuadrit ligjor të sipër cekur, Kolegji i Këshillit fillimisht konstaton s lidhur me pozitën Reference: pozitën Asistent Administrativ, si kërkesa të përgjithshme formale kanë qenë: *Arsimi i kërkuar: Diplomë e shkollës së mesme apo ekuivalente me të, Kërkesa Specifike: Nuk ka dhe Përvoja e punës e kërkuar: Nuk kërkohej*, andaj, nga analizimi i dokumentacionit të ankueses i dorëzuar më rastin e aplikimit (online) vërtetohet së i njëjti nuk ka bashkangjitur diplomë e shkollës së mesme por Diplomën me Nr. 300 të datës 26.04.2021, për përfundimin e studimeve themelore në Fakultetin e Filologjisë, kështu që, refuzimi i aplikacionit të ankuesit sipas njoftimit të datës 20.02.2026, të nëjssisë përgjegjëse të Komunës së Gjakovës konsiderohet veprim i drejtë dhe i nxjerrë në pajtim me nenin 9 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7, nenin 39 paragrafi 7 nën paragrafi 7.1 dhe paragrafi 8 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Kolegji i Këshillit mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”,* ka analizuar në kuptim të parimit të meritës aplikacionin e kandidates fituese të datës 03.02.2026, dhe si rrjedhojë ka gjetur se e njëjta posedon Diplomën më Nr. 872/5 të datës 17.08.2021, me të cilën dëshmohet se më datë 17.06.1996, ka përfunduar shkollën e mesme në Gjimnazin “Hajdar Dushi” në Gjakovë, e duke qenë së e njëjta ka arritur numrin më të madh të pikëve të vlerësimit, atëherë, më të drejtë institucioni gjegjes e ka shpallur si kandidatë fitues për procedurën me numër reference RN00019195, siç përcaktohet me nenin 11 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Bazuar në konstatimet si me lartë, dhe duke qenë se nuk janë evidentuar shkelje ligjore në procedurën e kontestuar, atëherë, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundimin se procedura e pranimi për pozitën e punës *asistent administrativ* është zhvilluar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë si dhe Rregulloren Nr.15/2023 për Pranimin në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kështu që, në kuptim të dispozitave të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.351/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, F.A;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.